



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Kuvendi

**PROJEKTLIGJ**

Nr. \_\_\_\_\_/2021

**PËR**

**NJË SHITESË DHE DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.92/2014,**  
**“PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR NË REPUBLIKËN**  
**E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

**V E N D O S I:**

Në ligjin nr.92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

**Neni 1**

Në nenin 49, “Shkallët e reduktuara”, pas pikës 9, shtohet pika 10, me këtë përmbajtje:

“10. Shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar, e cila aplikohet për furnizimin e inputeve bujqësore, siç janë plehrat kimike, pesticidet, farat dhe fidanët, përveç hormoneve të klasifikuara në kodet 2937 të Nomenklaturës së Kombinar të Mallrave, është 10 për qind. Lista e kategorive të inputeve bujqësore përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

**Neni 2**

Shkronja “nj”, e nenit 51, “Përjashtimi i disa veprimtarive me interes të



**TRIAL STUDIO**

përgjithshëm”, shfuqizohet.

**Neni 3**

Në pikën 38, të nenit 56, “Përjashtime të veçanta në import”, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Në shkronjën “a”, shifra “... 50 milionë lekë;” zëvendësohet me “... 500 milionë lekë;”;
2. Shkronja “c” shfuqizohet.

**Neni 4**

Në nenin 148, “Norma e kompensimit të prodhuesit bujqësor”, fjalët “...6 për qind.” Zëvendësohen me “... 0 për qind.”.

**Neni 5**

Ky ligj botohet në “Fletoren zyrtare” dhe hyn në fuqi më 1 janar 2022.

**K R Y E T A R I**

**LINDITA NIKOLLA**